



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 318, datë 16.09.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARES SË SKEMËS SË DELEGIMIT
ZNJ.{...}, NË GJYKATËN E APELIT KORÇË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës aktuale dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Korçë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 16.09.2021.
2. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Korçë për periudhën deri më datë 20.10.2020.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
4. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Korçë.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së skemës së delegimit, znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR